



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministristvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*



Udhëzues për prindër

PËRFSHIRJA E PRINDËRVE NË ARSIM

Udhëzues për prindër

PËRFSHIRJA E PRINDËRVE NË ARSIM

Falënderim

Ky material është zhvilluar dhe publikuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH në emër të Qeverisë Gjermane. Teksti origjinal në gjuhën Shqipe [2019]. E drejta për përdorim, riprodhim dhe redaktim i është bartur Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) [2023]. Përmbajtja e tekstit origjinal është përgjegjësi e autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyron opinionin zyrtar të Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH apo të Qeverisë Gjermane.

Autorë:

Malin Gütschow, Universiteti i Leipzig, Gjermani

Julian Plath, Universiteti i Bremenit, Gjermani

Albulena Grajçevci, konsulente

Grupi punues:

Vesel Hoda, GIZ

Zana Dobruna, GIZ

Alberta Alihajdari, GIZ

Dizajni dhe faqesja:

Envinion, Prishtinë

Falënderimet

Falënderojmë shkollat fillore dhe të mesme të ulëta: "Azem Bejta" dhe "Motrat Qiriazit", Klinë; "Dardania" dhe "Hilmi Rakovica", Prishtinë; "Ibrahim Oruçi" dhe "Selami Hallaqi", Gjilan; "Kadri Zeka", Kaçanik; "Lekë Dukagjini" dhe "Luigj Gurakuqi", Prizren; "Mihail Grameno", Fushë Kosovë, për pjesëmarrjen e tyre në studimin mbi të cilin është bazuar ky doracak.

Një falënderim i veçantë shkon edhe për 26 partnerët tanë të intervistuar, të përbërë prej prindërve, mësimitdhënësve dhe drejtorëve të shkollave, si dhe Kryetarin e Këshillit të Prindërve të Kosovës, z. Ymret Reshiti, që kanë ndarë kohën për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe atë me një çiltërsi dhe sinqeritet të madh. Pa këto njohuri të dorës së parë, zhvillimi i këtij doracaku nuk do të ishte i mundshëm.

Kërkoet një
fshat i tërë
për të rritur
një fëmijë

ANONIM



PËRMBAJTJA

1. HYRJE	6
2. PSE ËSHTË E RËNDËSISHME PËRFSHIRJA E JUAJ	9
3. DOBITË E PËRFSHIRJES SË PRINDËRVE.....	10
4. UDHËZUES PRAKTIK PËR PRINDËR – TË DREJTAT TUAJA, PËRGJEGJËSITË TUAJA	12
4.1. Prindërimi.....	12
4.2. Komunikimi me mësuesin/mësuesen/shkollën	14
4.3. Vullnetarizmi në shkollë.....	15
4.4. Të nxënës apo mësues në shtëpi	17
4.5. Pjesëmarrja në vendim-marrje.....	26
5. PËRFUNDIMI.....	30
6. SHTOJCA.....	31

1. HYRJE



Kërkohet një fshat i tërë për të rritur një fëmijë


ANONIM

Ky udhëzues përmban këshilla praktike për mbështetjen tuaj në rolin tuaj si prindër për të kontribuar në formësimin e fëmijës tuaj në shtëpi dhe në shkollë.

Qëllimi kryesor i këtij udhëzuesi është që të ju rikujtoj që roli juaj është kyç në zhvillimin e fëmijës, andaj po që se dini se si të kaloni kohë cilësore me fëmijën tuaj duke siguruar një mjedis stimulues brenda shtëpisë si dhe duke qenë aktiv edhe brenda shkollës, padyshim që suksezi i fëmijës tuaj do të jetë i garantuar. Ky udhëzues është orientuar të ofroj shpjegime mbi rëndësinë e përfshirjes, dobisë e saj dhe mënyrat praktike se si të bëhet kjo përfshirje. Në kuadër të këshillave të ofruara brenda këtij udhëzuesi janë përmendur edhe llojet e aktiviteteve të cilat mund të merren si pikë fillestare, gjithmonë duke motivuar prindin që të vijë edhe me vetë iniciativa. Këto këshilla janë bazuar kryesisht në metodën Hoover-Dempsey & Sandler e cila aplikohet në shumë vende të botës, dhe e cila si e tillë ka rezultuar shumë e suksesshme.


A keni dëgjuar ndonjëherë për Trekëndëshin e Arsimit? Trekëndëshi i Arsimit synon të paraqes marrëdhënie të mira mes tre akterëve kryesorë të shkollës: nxënësve, mësimitdhënësve dhe prindërve. Përfshirja në edukimin e fëmijëve tuaj është vendimtare për suksesin e tyre - në shkollë dhe gjatë gjithë jetës. Prandaj, ju prindër duhet të jeni të përfshirë në shkollë. Jo vetëm me mbështetjen e fëmijës tuaj duke bërë detyrat e shtëpisë, por edhe të qëndroni në kontakt me mësimitdhënësit dhe të bëheni aktiv në përmirësimin e mjedisit shkollor.

Në këtë udhëzues, do të gjeni këshilla praktike për ju si prindër, se si të merrni një rol më aktiv në edukimin e fëmijës tuaj duke ndërmarrë hapa shumë të thjeshtë. Rekomandimet për këtë udhëzues janë grumbulluar nga prindërit, mësimitdhënësit, drejtorët e shkollave dhe ek-



spertët e arsimit. Juve ju lusim ti përdorni këto këshilla si bazë për zhvillimin e ideve tuaja për përfshirje në zhvillimin e fëmijës tuaj në shtëpi dhe në shkollë.

Pjesa e parë e udhëzuesit shpjegon qëllimin e udhëzuesit, ndërsa pjesët tjera përmbajnë informata mbi të drejtën tuaj ligjore për të marrë pjesë në shkollimin e fëmijës tuaj, për praktikat më të mira të përfshirjes tuaj në shtëpi dhe në shkollë, si dhe mundësinë për të qenë pjesë e Këshillit të Prindërve apo Këshillit Drejtues të Shkollës.



Përfitimet për shkollat

- përmirësimi i infrastrukturës dhe mjedisit të mësimi;
- mësimdhënës më të motivuar për të arritur rezultate më të larta;
- partneritet më të fuqishëm me prindërit për të adresuar sfidat me të cilat ballafaqohet shkolla.



Përfitimet për fëmijën

- mësimnxënie e cilësisë më të lartë;
- përbushje më e madhe e të qenit i dashur dhe i përkujdesur nga prindërit;
- vetëvlerësim më të lartë;
- të qenit i mbështetur si në zhvillimin e përparësive ashtu edhe në tejkalimin dobësive të tyre;



Përfitimet për prindërit

- formësimi i edukimit të fëmijëve të tyre;
- sigurimi i perspektivave më të mira për të ardhmen e fëmijëve duke përmirësuar rezultatet e të nxënit;
- të kënaqur duke qenë pjesë e frymës së komunitetit;
- realizimi i ideve në shkollë me qëllim të rritjes së cilësisë;

2. PSE ËSHTË E RËNDËSISHME PËRFSHIRJA E JUAJ

“ Që të jeni në kujtesën e fëmijës tuaj nesër, duhet të jeni të përfshirë në jetën e tyre sot.

ANONIM

Arsimimi i fëmijës tuaj do të mbetet një nga momentet kryesore në përvojën tuaj si prind. Për shumë prindër shpesh procesi i ofrimit të ndihmës për të nxënëit e fëmijës mund të jetë sfidues. Megjithatë, një konstatim është se përfshirja e prindërve në çfarëdo forme në arsimimin e fëmijëve të tyre, ndikon në arritjet dhe të nxënëit e fëmijës në një shkallë më të madhe. Kur flasim për përfshirjen e prindërve i referohemi aktiviteteve në shtëpi (d.m.th tregoni interesim për atë që fëmija juaj po mëson në shkollë, kontrolloni detyrat e shtëpisë, monitoroni mësimet e tij/saj), si dhe aktivitetet në shkollë (takime prindër-mësimdhënës, vullnetarizëm në shkollë, pjesëmarrje në punëtori të prindërve).

Përfshirja juaj si prind, do të sigurojë që fëmija i juaj të mësojë më shumë fjalë dhe të mund të flasë rrjedhshëm, ndërsa gjithashtu të jetë më i mirë në zënieën e shokëve. Për këtë qëllim, nëse jeni të përfshirë në shkollë dhe në edukimin e fëmijëve tuaj në shtëpi ju do të siguron që fëmijët tuaj të mësojnë dhe të arrijnë më shumë. Kjo do të ndikoj gjithashtu që fëmijët tuaj të kenë aspirata më të larta në të ardhmen. Në fund, përfshirja juaj si prind është një praktikë e fuqishme për të siguruar që fëmija juaj do të mësojë, zë miq dhe përfundimisht të arrijë më shumë në një periudhë afatgjate.

3. DOBITË E PËRFSHIRJES SË PRINDËRVE



Në fund të ditës, çelësi më i madh i suksesit të një fëmije është përfshirja pozitive e prindërve.

JANE D. HULL

Literatura sugjeron një mori dobish për fëmijët kur prindërit janë të përfshirë në arsimimin e tyre. Përfshirja juaj në shkollë do të ndikoj në:



Përmirësimi i të arriturave në arsim – Kur jeni të përfshirë në mësimnxënien dhe edukimin e fëmijës tuaj, fëmija juaj do të përmirësohet më shpejt në të gjitha lëndët. Përfshirja juaj gjithashtu lidhet me cilësinë e përgjithshme të shkollës. Duke u përfshirë në dhënien e ndihmës për fëmijën tuaj për të bërë detyrat e shtëpisë dhe për të mësuar në shtëpi, do të ndikoni drejtpërdrejt në të nxënit dhe nivelet e të arriturave. Për më tepër, kur ju si prind përfshihen në shkollë, do të jeni më të informuar për atë se çfarë po mëson fëmija i juaj, cilat detyra të shtëpisë i ka, çfarë mund të bëjë që të përmirësohet dhe çfarë duhet të punoni më shumë për të ndikuar drejtpërdrejtë tek zhvillimi i fëmijës tuaj. Përfundimisht, duke qenë i përfshirë në shkollë, do të jeni në gjendje të dëgjoni për shërbime shtesë që mund të jenë të dobishme për fëmijën tuaj. Duke treguar se jeni të interesuar dhe të gatshëm të futeni në këtë përvojë, keni më shumë gjasa të merrni këshilla dhe qasje nga mësimitdhënësit për të ndihmuar fëmijën tuaj të ketë arritje më të larta,



Përmirësimi i sjelljes – kur jeni të përfshirë në shkollën e fëmijës, fëmija juaj do të ketë shkathësitë më të mira sociale si dhe do të shfaq sjellje të duhur në shkollë. Fëmija i juaj do të ketë më shumë gjasa të përfundojë detyrat e tij të shtëpisë, të mos e pengojë klasën dhe përfundimisht të mos mungojë nga orët e mësimit . Në përgjithësi, përfshirja juaj nuk duhet të kufizohet vetëm tek puna me fëmijën tuaj në shtëpi, por gjithashtu ju duhet të nxisni një sjellje të caktuar te ata duke qenë shembull për ta. Ju si prind, ndër të tjera, duhet ta mësoni fëmijën tuaj të jetë i qytetëruar, të dëgjojë mësimdhënësin kur ai është duke shpjeguar materialin, dhe t'i respektojë të gjithë.



Rritja e vetëbesimit – Nëse e mbështesni fëmijën tuaj në mjedisin e shtëpisë dhe shkollës, fëmija juaj ka më shumë gjasa të zhvillojë një qëndrim pozitiv ndaj shkollës, t'i japë prioritet mësimi dhe arritjeve si dhe të ketë vetëbesim më të lartë. Nëse jeni të përfshirë, fëmija juaj do të ndihet më i respektuar dhe i përfshirë në shkollë.

4. UDHËZUES PRAKTIK PËR PRINDËR – TË DREJTAT TUAJA, PËRGJEGJËSITË TUAJA

“ Ka shumë mënyra për të zgjeruar botën e fëmijës tuaj. Dashuria e librave është më e mira nga të gjitha.

JACQUELINE KENNEDY ONASSIS

4.1. Prindërimi



Prindërimi i referohet të gjitha aktiviteteve që bëhen nga ana e prindërve në mënyrë që të ndikohet në mënyrë pozitive në shëndetin, lumturinë dhe aftësitë e fëmijëve. Në këto aktivitete përfshihen ndër të tjera aktivitetet që synojnë zhvillimin e fëmijës, sigurisë, shëndetit si dhe mjedisit dhe ambientit në shtëpi që ndërlidhen ngushtë me mësimin e nxënësve.

Raporti i mirë me fëmijën tuaj është parakusht për suksesin në arsim

Ju si prindër luani rol shumë të rëndësishëm në jetën e fëmijës tuaj. Formësimi i fëmijës tuaj si person me vetëbesim dhe të lumtur varet shumë nga dashuria dhe mbështetja juaj. Kjo mënyrë e mbështetjes së fëmijës tuaj nuk është vetëm shumë e dobishme për ta, por gjithashtu e bën jetën tuaj më të lehtë dhe më të bukur.

Për të pasur një marrëdhënie të mirë me fëmijën tuaj, është e rëndësishme që të kaloni kohë cilësore me të. Nuk është e mjaftueshme të jeni në të njëjtën dhomë ose të uleni pranë njëri-tjetrit duke shikuar televizionin. Mendoni alternativa si p.sh. që të hani së bashku, të diskutoni për një film që e keni parë, të luani ndonjë lojë që kërkon komunikim, ose duke të shkoni për një shëtitje jashtë ku mund të bisedoni përgjatë rrugës. Çdo



ditë duhet t'i kushtoni pak kohë ekskluzivisht fëmijës tuaj. Fikeni televizionin, largoni telefonat e mençur dhe dëgjoni komentet dhe mendimet e djalit ose vajzës tuaj. Fëmijët kanë ide interesante, jepuni atyre mundësinë për t'i shkëmbyer ato me ju.

Vetëbesimi është çelësi për suksesin në shkollë dhe në jetë. Që fëmija i juaj të bëhet person me vetëbesim, duhet të besoni tek ai/ajo. Çdo fëmijë ka një potencial të madh. Duke qenë i afërt me fëmijën tuaj, ju jepni një kontribut të jashtëzakonshëm aftësisë së tij për të përmbushur këtë potencial.

4.2. Komunikimi me mësimdhënësin/shkollën



Familjet dhe shkollat komunikojnë përmes kanaleve të ndryshme të komunikimit. Për të ilustruar këtë, shkollat komunikojnë me prindërit kur u dërgojnë fletushka dhe shënime rreth aktiviteteve ose ngjarjeve të organizuara nga shkolla. Shumë shpesh shkollat komunikojnë me prindërit përmes faqeve të internetit të shkollave. Po ashtu, prindërit komunikojnë me shkollën kur shkëmbejnë informata të vlefshme për të nxënëit e fëmijës ose shëndetin e tij/saj.

Kuptoni se çka pritët prej juve si prindër

Shpesh si prindër humbisni mundësinë që të përfshiheni në edukimin e fëmijës tuaj, sepse nuk jeni të sigurt për atë se cilat janë përgjegjësitë tuaja. Në fillim të çdo gjysmë vjetori pyetni mësimdhënësin për atë se çka ai pret prej juve si prind. Mundohuni të grumbulloni informata të caktuara rreth asaj që ju duhet të bëni për të ndihmuar fëmijën tuaj.

Caktoni takime me mësimdhënësin për të diskutuar rreth fëmijës tuaj

Në rastet kur keni nevojë për informata shtesë për fëmijën tuaj, ju lusim të planifikoni një takim individual me mësimdhënësin. Përgatituni për takimin duke hartuar një listë të çështjeve që dëshironi të diskutoni. Komunikoni me sinqeritet me mësimdhënësin dhe bëhuni të hapur duke vlerësuar këshillat e tyre profesionale. Keni parasysh që mësimdhënësi dhe ju jeni partnerë në këtë proces.

Kërkoni mundësitë për t'u përfshirë

Kurdo që është e mundur, pyetni mësimdhënësin nëse ka ndonjë gjë që mund të bëni për të dhe për shkollën duke diskutuar çështje të caktuara me të cilat mund të ndihmoni. Po që se luani ndonjë instrument muzikor, atëherë ofroni ndihmë në mësimet e muzikës. Në rastet kur mësimdhënësi planifikon të përgatis një vizitë studimore, ofroni mundësinë për ta shoqëruar dhe ndihmuar në organizimin e ngjarjes. Mundësi të tjera të përfshirjes janë realizimi i një vizite në vendin ku punoni dhe të bisedoni me fëmijët rreth asaj se çfarë do të thotë të zgjidhni profesionin që keni. Përdorni imagjinatën dhe kreativitetin tuaj, mundësitë për përfshirje janë të pafundme.

4.3. Vullnetarizmi në shkollë



Vullnetarizmi është një mënyrë shumë e mirë për t'u përfshirë në edukimin e fëmijës tuaj. Vullnetarizmi i prindërve nënkupton vënien në dispozicion të prindërve për të ndihmuar rreth aktiviteteve në shkollë. Në këtë drejtim ju si prind mund të përfshihen në tri praktika të ndryshme të ofrimit të ndihmës vullnetare.

Së pari mund të lajmëroheni vullnetar për të ndihmuar mësimdhënësit drejtpërdrejt, me grumbullimin e mjeteve ose me blerjen e materialeve të nevojshme, apo edhe në rregullimin e mjedisit të klasës ose oborrit të shkollës. Përpos kësaj mund të mbështesni mësimdhënësin në organizimin e aktiviteteve jashtë klasës dhe ta shoqëroni në vizita të ndryshme.

Së dyti, mund të lajmëroheni vullnetar për të ndihmuar shkollën, si për shembull në mbledhjen e fond-eve.

Së treti, mund të bëheni anëtarë të këshillit të prindërve dhe të këshillit drejtues të shkollës ku mund të përfaqësoni zërin e prindërve të tjerë.

Komunikoni rregullisht me mësimpldhënësin

Komunikimi juaj me mësimpldhënësin është çelësi i suksesit të të nxëniet të fëmijës tuaj. Prania juaj në shkollë e motivon fëmijën tuaj të japë më të mirën e tij/saj dhe ju ndihmon të punoni së bashku me mësimpldhënësit për të përmirësuar procesin e mësimit të fëmijës tuaj. Thjesht duke u paraqitur në shkollë ju mund ta rrisni motivimin dhe performancën e fëmijës tuaj. Shfrytëzoni mundësitë për të komunikuar me mësimpldhënësin rreth përparimit të fëmijës tuaj, në mbledhje të përgjithshme me gjithë klasën si dhe në orë individuale konsultimi prindër-mësimpldhënës. Në këtë mënyrë mund të punoni së bashku për një problem që ka fëmija juaj ose të zhvilloni një strategji për të mbështetur tutje talentet e tij/saj.

Organizoni ndonjë ngjarje

Diskutoni me mësimpldhënësin për mundësinë e organizimit të ndonjë ngjarjeje. Një shembull do të ishte organizimi i një pikniku dhe ftuarja e prindërve të tjerë për të sjellë ushqime dhe pije për fëmijët. Këto organizime përforcojnë marrëdhëniet mes prindërve, gjë që ndikon pozitivisht edhe tek marrëdhëniet mes fëmijëve.

Ofroni ndihmën tuaj për mësimpldhënësin

Shpesh mësimpldhënësit e kanë përshtypjen se prindërit janë të zënë dhe në këtë mënyrë nuk janë në gjendje të ndihmojnë në shkollë. Komunikoni me mësimpldhënësin se kur mund të jeni në dispozicion për të ndihmuar dhe tregoni se në cilën pjesë mund të ndihmoni. Ndoshta mund të ndihmoni me organizimin e lojës së shkollës, ose me prezantimet e nxënësve.

4.4. Të nxënit apo mësimi në shtëpi




Përfshirja juaj duke i ofruar ndihmë fëmijës në mësim në shtëpi është shumë e rëndësishme në edukimin e fëmijës tuaj. Ndonjëherë fëmija juaj mund të duket jo i gatshëm për të mësuar, andaj ju duhet ti kush-toni kohë për t'ia bërë të qartë se arsimi është i rëndësishëm. Kjo u ndodh të gjithë prindërve, por ka disa mënyra të thjeshta për të rritur motivimin e fëmijës tuaj për të mësuar:

Bisedoni me fëmijën tuaj lidhur me shkollën

Një mënyrë e thjeshtë dhe efektive për të treguar interesimin tuaj për arsimin është duke biseduar me fëmijën tuaj për shkollën. Duke e pyetur fëmijën tuaj për temat dhe aktivitetet e ditës i jepni fëmijës

mundësinë për të përsëritur përmbajtjen dhe për të reflektuar rreth saj, në të njëjtën kohë ju do të ndiheni të dashur dhe të përkujdesur në rolin tuaj si prind. Nëse ndani vetëm disa minuta bisedë individuale në ditë me secilin nga fëmijët tuaj kjo ju ndihmon për të forcuar ndjenjën e tyre të përkatësisë, duke rritur kështu motivimin e tyre për të punuar më shumë në shkollë. Kjo edhe do të ju bëjë juve krenar.



Bisedën mund ta filloni duke pyetur:
"Çfarë mësove sot?" ose "Cili ishte aktiviteti më argëtues sot?"



Inkurajoni fëmijën tuaj për të lexuar

Leximi është çelësi për arsimim, është roli juaj për të ndihmuar fëmijën tuaj të lexojë në shtëpi. Ju jeni modeli më i mirë i fëmijës tuaj - nëse ai ju sheh me libër, fëmija juaj është shumë më i motivuar të modeloj sjelljen tuaj duke lexuar. Çdo fëmijë mund të bëhet një lexues i pasionuar. Këtu janë disa këshilla se si mund ta zbuloni këtë potencial tek ata:

- * lexoni tregime fëmijës tuaj dhe bëni pyetje rreth tregimit
- * vizitoni vende të rëndësishme kulturore ose historike dhe lexoni historinë e atij vendi fëmijës tuaj
- * së bashku me fëmijën tuaj, gjeni një libër për një temë që ajo/ai është i pasionuar
- * regjistrohuni në një bibliotekë afër jush
- * vizitoni ndonjë panair të librit
- * inkurajoni fëmijën tuaj që të zë miq për të mësuar së bashku.

Planifikoni aktivitete jashtëshkollore

Shkolla merr vetëm një pjesë të vogël të kohës së fëmijës tuaj. Kështu që koha e mbetur mjafton për t'u plotësuar me aktivitete të tjera. Koha e shpenzuar me aktivitetet e ndryshme të kohës së lirë, nënkupton jo vetëm argëtim me fëmijën tuaj, është gjithashtu kohë e shpenzuar për të mësuar së bashku. Në varësi prej vendndodhjes tuaj, mund të ketë mundësi për aktivitete si:

- * sporte, p.sh. futboll, basket
- * muzikë (këndimi, luajtja e ndonjë instrumenti)
- * klube të ofruara nga shkolla (klubi i letërsisë, klubi i gjelbër, klubi shkencor, klubi i teknologëve)
- * aktivitete grupore të ofruara nga qendrat dhe organizatat e komunitetit.



Në këto aktivitete, fëmija juaj mund të fitojë njohuri për një temë, për të cilën është i pasionuar dhe të fitojë shkathtësi të rëndësishme si puna ekipore, të qenit i drejtë me fëmijët e tjerë, të qenit kureshtar dhe kreativ, dhe shumë gjëra të tjera.

Gjeni aktivitete arsimore argëtuese

Për të bërë aktivitete argëtuese mund të gjeni fleta pune përmes fjalëve kyçe në internet si “ngjyros sipas numrit” ose “kërkimi i fjalëve”, për të gjitha grup moshat të cilat për shembull mund të shërbejnë për të ushtruar matematikën, shkrim-leximin dhe gjuhën angleze. Shpesh, këto aktivitete mund t'i shkarkoni dhe shtypni, të cilat janë argëtuese në të njëjtën kohë edhe të dobishëm për fëmijën tuaj.

Krijoni rregulla për detyrat e shtëpisë

Për shumicën e fëmijëve, bërja e detyrave të shtëpisë nuk është gjëja më argëtuese që mund të imagjinojnë ta bëjnë në kohën e tyre të lirë. Nëse fëmija juaj ngurron të bëjë detyrat e shtëpisë, është mirë të vendosni rregulla të qarta lidhur me këtë çështje. Është veçanërisht e rëndësishme të rregulloni përdorimin e teknologjive, të cilat shpesh ndërhyjnë në kohën e ndarë për ti bërë detyrat e shtëpisë. Prindërit në mbarë Kosovën janë pyetur se si merren me këtë çështje dhe ata kishin një propozim të thjeshtë por të fuqishëm: vendosni një orar.




Përdorni teknologji që janë të dobishme për të mësuar

Nuk keni nevojë të ndaloni përdorimin e teknologjive të tilla si kompjuterë, televizion dhe telefona të mençur, ato mund t'i përdorni për të mirën e arsimimit të fëmijës tuaj. Ka shumë aplikacione për telefona të mençur që janë të dizajnuara posaçërisht për të ndihmuar fëmijën tuaj që të mësojë.

Për shembull:

Burime online:



Në gjuhën angleze: <https://learnenglishteens.britishcouncil.org/vocabulary>

Aplikacionet për telefona të mençur:

Matematikë: Matematikë për Fëmijë (zhvilluar nga beeapps)

Gjuhë angleze:


Mësoni anglisht fëmijë (Learn English Kids):

Koha e lojës (për iPhone, zhvilluar nga Këshilli Britanik)

Mësoni anglisht fëmijë (Learn English Kids):

Videot (për Android, zhvilluar nga Këshilli Britanik)

Letërsi: E Gjen Dot? (zhvilluar nga Albaniapps)



Përveç përdorimit të teknologjisë për të përfituar në procesin e të nxënës, është e rëndësishme të me fëmijën tuaj rreth rreziqeve që sjell interneti, të tilla si humbja e kontaktit me miqtë e jetës reale dhe njohja e personave të huaj të rrezikshëm.

Kërkoni mbështetje në ato fusha në të cilat nuk mund ta ofroni ju vet

Shpesh, mund të mendoni se nuk jeni në gjendje të mbështesni fëmijën tuaj me detyrat e shtëpisë, sepse as ju vet nuk dini mjaft rreth temës. Sidoqoftë, edhe pa pasur asnjë ide në lidhje me temën përkatëse, mund të ofroni mbështetje të vlefshme për fëmijën tuaj:

- * kërkoni ndihmë nga anëtarët e tjerë të familjes ose miqtë
- * ftoni shokët e klasës ose nxënësit e një klase më të lartë për të bërë detyrat e shtëpisë së bashku me fëmijën tuaj
- * kërkoni mesazhet e idetë lidhur me detyrat e shtëpisë
- * udhëzoni fëmijën tuaj ku mund të marrë ndihmë
- * shfrytëzoni mundësitë e tilla si Qendrat Mësimore që janë pjesë e disa shkollave.

Mbështetni fëmijën tuaj në rrugën e tij drejtë përmirësimit

Kur fëmija juaj nuk i plotëson pritjet për sa i përket arritjeve dhe rezultateve, ai ka nevojë për mbështetjen tuaj për t'u përmirësuar. Nëse fëmija juaj e din se ju besoni në të, edhe ai do të besojë tek vetja gjithashtu. Ky është parakushti më i rëndësishëm për përmirësim.

Punoni së bashku me fëmijën tuaj për të përmirësuar performancën e tij përmes:

- * reflektimit së bashku mbi arsyet për rezultatin e pakënaqshëm
- * hartimit të një "plani të përmirësimit" së bashku me fëmijën dhe në diskutim me mesimdhënësin, plan ky që mund të ju ndihmojë që të përcaktoni objektivat afatshkurtra dhe afatgjata dhe hapat për t'i arritur ato
- * intensifikimit të komunikimit me mesimdhënësin
- * të qenit të vëmendshëm ndaj të gjitha rrethanave që mund të zvogëlojnë performancën e fëmijës tuaj, të tilla si ndikimet negative të disa miqve, abuzimit me drogën, ngacmimit etj.



Pyetjet për të ftuar fëmijët që të reflektojnë lidhur me performancën e tyre:


- A je i kënaqur me këtë rezultat?
- Cilat mendon se janë arsyet për këtë rezultat?
- Çka mund të bësh ndryshe për të arritur rezultate më të mira?
- Çka dëshiron të ndryshosh në të ardhmen për t'u përmirësuar?
- Si mund të mbështes për tu përmirësuar ?

Mos harroni, **mësimi është më shumë sesa notat**. Shumë shkathtësi që janë me të vërtetë të rëndësishme për një jetë të lumtur dhe produktive nuk pasqyrohen në nota. Ato janë ndër të tjera fryma ekipore, durimi, ndjeshmëria, besueshmëria, vetëbesimi, etj. Nëse vëreni ndryshime pozitive tek fëmija juaj, lavdëroni atë lidhur me këtë.

Mbështeteni fëmijën tuaj në ndjekjen e pasioneve të tyre

Mos u fokusoni shumë në dobësitë e fëmijës tuaj, ju duhet të dini që ai/ajo gjithashtu ka talente, pasione dhe pika të forta që duhet të njihen dhe të përmenden. Në fund, këto mund të jenë tema dhe aktivitete që formësojnë të ardhmen personale dhe profesionale të fëmijës tuaj. Vajzat dhe djemtë mund të jenë njëjtë të interesuar në futboll, matematikë, biologji dhe letërsi, sepse interesat e tyre nuk duhet të lidhen me gjininë. Si prind, është roli juaj për të vërejtur interesat dhe talentet e fëmijës tuaj e më pas ti mbështetni më tutje në zhvillimin e tyre.

Idetë për të përforcuar interesimin e fëmijës tuaj në...




...shkencat kompjuterike:

- Faqet e internetit:
p.sh. codeacademy.com;
hackerrank.com
- aplikacionet: SoloLearn



...kimi:

- mund të gjeni udhëzime për eksperimente të lehta në youtube



...sporte:

- aktivitete sportive jashtë shkollës, të tilla si futboli, basketboli, vrapimi, kërcimi, etj.



...letërsi:

- shkruani poezi dhe prezantoni ato njëri tjetrit



...biologji

- shëtitni në natyrë për të mësuar rreth bimëve dhe kafshëve



...histori:

- zbuloni së bashku historinë e qytetit tuaj dhe paraardhësve tuaj



...teatër:

- zhvilloni dhe përdorni një shfaqje ekzistuese dhe ushtroni së bashku

Së bashku çdo gjë është më argëtuese sesa ajo e bërë vetëm, kështu që përpiquni të gjeni fëmijë të tjerë me të njëjtin interesim dhe ftojini ata të marrin pjesë.

4.5. Pjesëmarrja në vendim-marrje

Ju mund të angazhoheni në edukimin e fëmijëve tuaj duke marrë pjesë në struktura vendim-marrëse. Përmes kësaj pjesëmarrjeje ju mund të ndikoni në arritjet e fëmijëve tuaj, duke u bërë pjesë e Këshillit të Prindërve, dhe e Këshillit Drejtues të Shkollës.

Kërkoni arsim cilësor për fëmijën tuaj

Fëmija juaj ka të drejtë të ketë qasje në arsim me cilësor. Nëse ju mendoni se shkolla nuk ofron arsim të cilësisë së lartë, mund të kërkoni nga mësimdhënësit dhe drejtorja e shkollës për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies përmes:

- * adresimit të çështjes me mësimdhënësit ose drejtorinë e shkollës
- * paraqitjes së ankesës tuaj në Këshillin e Prindërve
- * formimit të një grupi me prindërit e tjerë për të rritur kërkesat ndaj shkollës.

Sipas ligjit, prindërit duhet të përfshihen në vendimmarrjen në shkollë. Në secilën shkollë duhet të ekzistojë Këshilli i Prindërve dhe Këshilli Drejtues i Shkollës, ku përfaqësuesit e prindërve kanë të drejtë të marrin pjesë në vendimmarrje. Nëse dëshironi të angazhoheni më shumë për fëmijën tuaj dhe për shkollën, merrni parasysh që të paraqiteni vullnetarisht si përfaqësues i prindërve në aktivitetet e Këshillit të Prindërve apo edhe në aktivitete të tjera të shkollës.

Kontribuoni në përmirësimin e shkollës

Edhe pa qenë pjesë e Këshillit të Prindërve, ka shumë gjëra në shkollë ku mund të kontribuoni dhe të bëni ndryshim, për një mjedis më të mirë mësimor të fëmijës tuaj.

Për shembull, mund të:

- * punoni vullnetarisht për të përmirësuar infrastrukturën e shkollës,
- * ofroni ekspertizën tuaj për të planifikuar projekte, ose
- * mblihdni fonde për të financuar.

Gjithashtu, ju, prindërit e tjerë, nxënësit dhe shkolla mund të bashkoni forcat për të paraqitur kërkesa për mbështetje tek komuna ose financues të tjerë të mundshëm, sepse së bashku keni një zë më të fortë.

Kërkoni të drejtat tuaja për pjesëmarrje

Nëse mendoni se shkolla e fëmijës tuaj nuk ju ofron mundësi të përfshiheni në aktivitete, tani është koha për t'u bërë aktiv. Për shembull, nëse mbledhjet e prindërve më mësimdhënës mbahen gjatë orarit tuaj të punës, kërkoni nga mësimdhënësi që të ndryshojë orarin. Është e drejta juaj të informoheni për arsimimin e fëmijës suaj, kështu që shkolla duhet të bëjë çmos që t'ju mundësojë të merrni pjesë në takime. Përveç kësaj, mund t'i kërkoni mësimdhënësit të komunikojë edhe nëpërmjet burimeve të tjera (telefon, internet, etj). Kjo ju mundëson që të jeni afër procesit mësimor të fëmijës tuaj, edhe nëse nuk mund të jeni personalisht i pranishëm në shkollë rregullisht. Ndonjëherë mund të mendoni se i vetëm mund të bëni shumë pak për të ndryshuar shkollën e fëmijës tuaj, por mbani mend: ka shumë prindër që mund të ndihen njësoj si ju - bashkoni forcat me ta, së bashku mund të bëni që të dëgjohet zëri i juaj në shkollë.

Nëse keni ndonjë ide për ndonjë aktivitet të përbashkët me prindërit, nxënësit dhe mësimdhënësit, propozojeni atë.

Përfaqësimi i prindërve në shkollë



DETYRAT KRYESORE

Elaboron Planin Zhvillimor të Shkollës

Kontrollon Cilësinë e Mësimdhënies dhe Financat

Miraton Rregullat e Shkollës dhe diskuton Projekte të reja

PËRBËRJA

3

Mësimdhënësit nga Këshilli i Mësimdhënësve

2


Akterët nga shoqëria

1

Nxënësit nga Këshilli i Nxënësve

3

Prindërit nga Këshilli i Prindërve



DETYRAT KRYESORE

Përfaqëson interesat e prindërve

Bashkëpunon për të përmirësuar mësimdhënien dhe mësimnxënien

Rrit atraktivitetin e shkollës


PËRBËRJA

1

Prindi për klasë

2

Përfaqësues të nxënësve (pa të drejtë vote)



Merrni pjesë në Këshillin e Prindërve të Shkollës

Në takimin prindër-mësimdhënës, mund të zgjidhni një përfaqësues të klasës tuaj në Këshillin e Prindërve ose të bëheni përfaqësues vetë ju. Këshilli i Prindërve mbledh interesat e të gjithë prindërve dhe ua komunikon ato shkollës. Rreth 2-4 anëtarë të Këshillit të Prindërve gjithashtu bëhen anëtarë të Këshillit Drejtues të Shkollës. Ky është organi më i lartë i shkollës me kompetencat më të mëdha. Ai kontribuon në hartimin e Planit Zhvillimor të Shkollës dhe e miraton atë, kontrollon cilësinë e mësimdhënies dhe shpenzimet, miraton rregullat e shkollës dhe planifikon projekte të reja. Këtu, prindërit mund të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në marrjen e vendimeve në lidhje me shkollën dhe zhvillimin e saj të mëtejshëm.

Për të funksionuar në mënyrë optimale, Këshilli i Prindërve duhet të:

- * takohet rregullisht
- * diskutojë problemet në shkollë
- * komunikojë me të gjithë prindërit lidhur me zhvillimet më të fundit në Këshillin e Prindërve
- * planifikojë aktivitete dhe projekte dhe t'i propozojë ato Këshillit Drejtues të Shkollës
- * formojë grupe punuese për çështje të caktuara (p.sh. braktisja e shkollës)
- * punojë së bashku me organe të tjera të shkollës

Edhe kur nuk jeni anëtarë i Këshillit të Prindërve, ju mund t'u jepni sugjerimet tuaja mbi projektet për të përmirësuar shkollën. Kur dëgjoni për ndonjë aktivitet që do të realizohet, ofroni ndihmën tuaj.

Këshilli i Prindërve nuk duhet të ngurrojë të kritikojë ato edhe nëse kanë mendim tjetër se si të zgjidhin ndonjë problem. Secili ka të drejtë të jetë pjesë e shkollës, ndërsa me këto të drejta vijnë edhe obligimet. Angazhimi juaj në shkollë ndihmon në përmirësimin e cilësisë në arsim ku përfitues janë të gjithë fëmijët.

5. PËRFUNDIM

Të jesh prind nuk është përgjegjësi e thjeshtë. Fëmija juaj merr shembull nga ju për shumëçka, andaj bëhuni shembull pozitiv për të. Përfshirja juaj aktive ka efekt në rritjen e rezultateve mësimore si dhe në formimin e sjelljeve të cilat janë të rëndësishme për ta përgatitur fëmijën tuaj që të veproj në mënyrë të qytetëruar me të tjerët.

Shkolla dhe mësuesit gjithashtu kanë një rol të rëndësishëm, ky rol mund të jetë i suksesshëm vetëm atëherë kur ju provoni të jeni partner me shkollën dhe mësuesin. Prindërit dhe mësuesin së bashku mund të jenë shumë më efektiv në arsimimin e fëmijëve. Ata mund të sigurojnë që fëmijët t'i përgatisin më së miri me shkathhtësitë e nevojshme për rolin e tyre si qytetarë të përgjegjshëm.

Shpresojmë që ky udhëzues ju ka dhënë mjaft këshilla praktike për mbështetjen tuaj në rolin tuaj si prindër për të kontribuar në zhvillimin e fëmijës tuaj si në shtëpi dhe në shkollë.

Andaj, prindër të dashur merreni me përgjegjësi rolin tuaj dhe përfshihuni në mënyrë aktive në arsimimin e fëmijës tuaj.

6. SHTOJCA

GJEJ FJALËT NË VIJIM DHE RRETHO ATO: PRILL, VIT, DHJETOR, FESTË, I RI, ÇOKOLLATË, ZEMËR, DHURATË, DËSHIRË, BRENDA, JASHTË, SHAKA, GOSTI, USHQIM, KOSTUM, PEMA,

K	P	E	M	A	Z	E	M	Ë	R
O	SH	O	K	R	F	E	S	T	Ë
S	A	G	O	S	T	I	V	A	A
T	K	M	E	T	P	R	I	LL	D
U	A	J	A	SH	T	Ë	I	O	N
M	K	DH	J	E	T	O	R	K	E
P	D	Ë	SH	I	R	Ë	I	O	R
E	P	U	U	SH	Q	I	M	Ç	B
M	Ë	T	A	R	U	DH	D	O	M

Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Mars 2019, Libri Im: Orë plotësuese për fëmijë të ri-atdhesuar, faqe 95

ZGJIDH PROBLEMET MATEMATIKORE DHE PASTAJ NGJYROS FIGURËN E TORTES SIPAS REZULTATIT TE MBETJES:

0 ngjyrë rozë

1 ngjyrë e verdhë

2 ngjyrë e kaltër

3 ngjyrë portokalli

4-1=

8-5=

9-6=

2-1=

5-2=

7-4=

1-1=

6-3=

6-5=

5-2=

2-2=

3-3=

9-9=

6-6=

5-4=

7-6=

7-5=

5-3=

4-3=

8-7=

8-5=

4-1=

Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Mars 2019, Libri Im: Orë plotësuese për fëmijë të ri-atdhesuar, faqe 107

GJEJ FJALËT DHE LIDHI:


KOHA, STINËT DHE MOTI
gjej fjalët dhe lidhi

R A
 K G
 M S M Q
 P N O X
 V Q A Ë R U
 V F T J V D
 A P U E T V D V
 A Ç L K E C I G
 S B L V E T K M J I
 M A Ç E R Ë D R A H
 L E L K N O V Y I F S J
 V Z B S A B E M V S O T
 T Y X V S Q A K B M H K O B
 L U R Ë T A K X Ë T A T H S
 E D C X L I F C K D H J E T Ë V
 V Ë T N Ë N N H B H V Ç M U A J
 Ç J U J D P A I L V J J U V V I T C
 P E J G A R O H I E E B X V I U R C
 J T Y U P D A Ç Z J G T S Y L P H Ë N Ë
 V G R X D K N J Ë M B Ë D H J E T Ë J Ë
 X A T H S E J V L G Y I Q K V Y S S C E T T
 C Ë L H I R J E V C T A L D E L Ë H L R I S
 L V S L O P Ë N R A D N M X V R L P R E P D A J
 T T R E E I N M A V M L A Ç O A L G J A S H T Ë
 I V X T I Q X Y Ç B Y D O I B T D L Z Y R M M Ç Ë B
 G A S U D J Z M Z L A N A O K N C A Q N Ë L D D S Ë
 J A V Ë
 O F C O
 H E V N
 Y O Ç Q

B O R Ë
 D H J E T Ë
 D I M R I
 D I T Ë
 D Y
 D Y M B È D H J E T Ë
 E R È
 G J A S H T Ë
 H È N Ë
 J A V Ë
 K A T È R
 M U A J
 N A T Ë
 N J Ë
 N J È M B È D H J E T Ë

N È N T Ë
 O R A
 P E S È
 P R A N V E R A
 S H T A T Ë
 S T I N A
 T E T Ë
 T R E
 V E R A
 V I T
 V J E S H T A

LEXO FJALËT QË TREGOJNË NGJYRAT. PASTAJ NGJYROSI HAPËSIRAT. KËSHTU DO TË KRIJOSH YLBERIN ME NGJYRA.



● Ngjyrë e kuqe ● Ngjyrë portokalli ● Ngjyrë e verdhë ● Ngjyrë e gjelbër ● Ngjyrë e kaltërt ● Ngjyrë manushaqe ● Ngjyrë vjollce

Burimi:
Ministria
e Arsimit,
Shkencës dhe
Teknologjisë,
Mars 2019,
Libri Im: Orë
plotësuese për
fëmijë të
ri-atdhesuar,
faqe 41


BASHKOJI SHKRONJAT NË BAZË TË ALFABETIT (36 SHKRONJAT)

						LL	L	K	J												
A									I						Z	Y	XH				
	B	C	Ç	D	DH	E	Ë	F	G	GJ	H			N	NJ	O	P	Q	X		
	Ç		DH			I		GJ		I	J	K	L	LL	M		Q		V		
	D		E		H		H										R		U		
	DH		Ë	F	F	G	H	I				NJ	O	P	Q	R	RR	S	SH	T	TH
	E		G		GJ		J					N					T		U		
	Ë		GJ	H	I	J	K	L	LL	M	N	NJ	O	P	Q	R	TH		V		
	F		H				NJ			N			P				U		X		
	G		I				N			NJ			Q				V		XH		
	L	K	J	K	L	LL	M	N	NJ	O	P	Q	R	RR	S		XH	Y	Z	ZH	



Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Mars 2019, Libri Im: Orë plotësuese për fëmijë të ri-atdhesuar, faqe 42

TANI BASHKOJI PIKAT SIPAS RENDITJES SË NUMRAVE NË MËNYRË QË TË FITOSH NJË FIGURË.
PASTAJ MUND TA NGJYROSËSH APO EDHE MUND TË SHTOSH GJËRA TJERA.



Burimi: Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Mars 2019, Libri Im: Orë plotësuese për fëmijë të ri-atdhesuar, faqe 62



Deutsche Gesellschaft für
Internationale
Zusammenarbeit (GIZ)
GmbH

Zyra Prishtinë
Rr. Anton Çeta Nr. 1
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

T +383 38 233 002 212
E giz-kosovo-buero@giz.de
I www.giz.de